



Njoftim publik

Në Komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa nr. 05-350/2-107612/26, dt. 20.07.2026 (Eleja-KKN-01272), e pronarit Daut Vllasaliu, përmes së cilës kërkohet të përcaktohen kritere të caktuara për ndërtim të ndërtesës/ shtëpi individuale banimore, me etazhitet P+1, në parcelën kadastrale nr. 728-23, ZK Cagllavicë në kuadër të Planit Rregullues të hollësishëm “Prishtina e Re-Zona Perëndim”.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 13.08.2026 deri më 17.08.2026, në E-mail adresën: urbanizmi@prishtine.gov.net

Kushtet e propozuara të ndërtimit:	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Shtëpi individuale banimore Me etazhitet P+1
b. Vija rregulluese	871.20 m' përgjatë rrugës publike
c. Vija ndërtimore	871.20m' nga vija rregulluese
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	640.0/871.20m'
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësorë dhe të pasmë të parcelës kadastrale.	640.0/301.0 veri 640.0/300.0 jug 640.0/100.70 lindje
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHP)	166.7m ² / e lejuar 115.40m ² / e projektuar
g. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese mbi tokë në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISPN)	450m ² / e lejuar 246.90m ² / e projektuar
h. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHGJ)	166.70m ² / e lejuar 167.23m ² / e projektuar
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHN)	/
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve	1(një) vend parkim
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	Po
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po - ☒ Jo - ☐ Nuk aplikohet - ☐	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe sesa zona përreth? Po - ☐ Jo - ☒ Nuk aplikohet - ☐ Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në zona të mbrojtura, zona të veçanta ose zona të veçanta të mbrojtura? Po - ☐ Jo - ☒ Nuk aplikohet - ☐ Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit administrativ 06/2017, dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës.

Në të gjitha komentet tuaja duhet të përshkruhet numri i kërkesës të shënuar më lartë.

Nënshkrimi i Zyrtarit: _____